I

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Bashkia e Qytetit Krujë
Këshilli i Bashkisë

# VENDIM

**Nr 52 Datë 31.08.2015**

**Për**

Miratimin e ndryshimit të aksionerit të Klubit të Futbollit Iliria sh.a. Fushë-Krujë nga Bashkia e qytetit Fushë-Krujë në Bashkinë Krujë dhe autorizimin e Z. Artur Bushi për të përfaqsuar Këshillin e Bashkisë në Asamblenë e Aksionerëve të Klubit të Futbollit "Iliria" sh.a. Fushë-Krujë "

Këshilli i Bashkisë Krujë, në mbledhjen e tij të datës 31.08.2015, pasi mori në shqyrtim materjalin e paraqitur nga Kryetari i Bashkisë , mbështetur në ligjin 8652 të datës 31.07.2000 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Qeverisjes Vendore" i ndryshuar neni 32 , ligji nr 9723 datë 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit" ligji nr. 9901 datë 14.04.2008 "Për tregëtarët dhe shoqëritë tregtare" i ndryshuar :

VENDOSI

1. Të miratojw ndryshimin e aksionerit të Klubit të Futbollit "Iliria" sh.a. Fushë-Krujë nga Bashkia e qytetit Fushë-Krujë në Bashkinë Krujë me 100% tw aksioneve .

2. Të miratojë autorizimin e Z. Artur Bushi për të përfaqsuar Këshillin e Bashkisë Krujë në Asamblenë e Aksionerëve të Futbollit "Iliria" sh.a. Fushë-Krujë.

3. Ky vendim hyn në fuqi pas konfirmimit për bazueshmëri ligjore nga Prefekti i Qarkut të Durrësit.

**Kryetari i Këshillit**

**Hysni Caca**

NJEHSOHET ME ORIGJINALIN
SEK. KESHILLIT
MALIQ REGI

Adresa: Qender Kruje , Tel./Fax 00355 511 23373 e-mail bashkiakruje@yahoo.com

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**BASHKIA FUSHE KRUJE**

**FUSHE KRUJE,ME** 09 /06/2011

**VENDIM**
**NR.**21 **DATË** 07-06-2011

**PËR PJESËMARJEN E BASHKISË FUSHE KRUJE SI AKSIONAR (I VETËM) NË THEMELIMIN E SHOQËRISË "ILIRIA "SH.A**

Mbështetur në ligjin nr. 8652, datë 31.07.2000, Për Organizimin dhe Funksionimin e Qeverisjes Vendore" i ndryshuar, **neni 8/VI/Paragrafi b,** si dhe **neni 32 pika d**"Keshilli Bashkiak miraton aktet e themelimit te nderrmarrjeve ,shoqerive tregtare,si dhe te personave te tjere juridike qe krijon vete ose eshte bashkethemelues "në mbledhjen e datës 07-06-2011 Këshilli i Bashkisë Fushe Kruje mori në konsideratë kërkesën e bërë nga Kryetari i Bashkise dhe pas diskutimit

**VENDOSI**

1. Bashkia Fushe kruje të marrë pjesë si aksionar (i vetëm) në themelimin e shoqërisë "Iliria" sh.a. me 100% të kapitalit
2. Shoqëria Iliria sh.a. do të jetë një shoqëri që do të ketë si objekt ekskluziv të veprimtarisë së saj krijimin, organizimin dhe drejtimin e një klubi futbolli përfaqësues të BashkisëFushe kruje sipas përcaktimeve që do të bëhen në statutin dhe aktet e themelimit të shoqërisë.
3. Të caktojë si përfaqësues të BashkisëFushe Kruje në asamblenë e aksionarëve të shoqërisë Iliria sh.a Kryetarin e Bashkise duke i dhënë të gjitha drejtat e vendimmarrjes dhe të përfaqësimit, përvec atyre që për shkak të ligjit janë në kompetencë të Këshillit të Bashkisë.

Ky vendim hyn në fuqi pas konfirmimit nga Prefektura
-Ngarkohet zyra Juridike te ndjeke procedurat e metejshme.

**KRYETARI I KESHILLIT**

**ENGJELL COLLAKU**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA -FUSHË-KRUJË-

VERTETOHET NJE ME ORIGJINALIN

SEK. KESHILLIT OSMAN META